



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 135 /2011

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 3 i Statutit të Komunës, Vendimin e Kuvendit të Komunës me numër 01/Nr.005/2011, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E MATERIALIT PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE PËR KRIMET E KRYEARA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NGA PUSHTETI SERB

I

Kuvendi i Komunës miratoi materialin e komisionit i cili ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave dhe fakteve për krimet e kryera në territorin e Komunës së Hanit të Elezit nga pushteti Serb.

II

Sipas nenit I të këtij vendimi materiali i grumbulluar nga komisioni përmban njëqind e pesë faqe dhe përfshin periudhën 1989 deri më 12.06.1999. Materiali i grumbulluar do të procedohet nga ana e ekzekutivit në organet kompetente.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Anëtarët e Komisionit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit

Hani i Elezit
Data:31.10.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

